

AKT I THEMELIMIT
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NELCO” SH.P. K

Sot, më 10/10/2023, në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë:

aaa

- 1. Arben Vrushi**, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan, më 28.09.1966, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 034148865, me nr. Personal G60928006U.
- 2. Bleri Dervishi**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, më 22.10.1993, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 035678793, me nr. Personal J31022026C.
- 3. Emiljan Leka**, shtetas shqiptar, lindur në Gruemirë, më 26.02.1990, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 035337758, me nr. Personal J00226142L.

I. Themelimi

1. Ortakët themelues vendosën për themelimin e shoqërisë " **NELCO**" Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën: Rruga Çlirimi, N 16/360, Zona Kadastrale 8522, Elbasan, Shqipëri.
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
 - Grumbullimi dhe përpunimi BMA (Bimë medicinale aromatike), mbetjet e Agrikulturës dhe Akuakulturës.
 - Prodhimi I ekstrakteve Botanike.
 - Prodhimi I substancave të pastra biokimike natyrale me teknologji të gjelbër.
2. Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
3. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

III. Statuti

Ortakët Themelues me anë të kësaj deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë .

IV. Kapitali Themeltar

1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Cdo ortak zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë

Ortakët zotërojnë kapitalin si më poshtë:

- **Arben Vrushi** – 50 % 5000 (pesë mijë) Lekë
- **Bleri Dervishi** – 25 % 2500 (dymijë e pesëqind) Lekë
- **Emiljan Leka** – 25 % 2500 (dymijë e pesëqind) Lekë


2. Kuotat janë të zakonshme dhe secili ortak ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote.
3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues.

V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë të çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme .
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:
 - **Bleri Dervishi, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, më 22.10.1993, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 035678793, me nr. Personal J31022026C.**

Akti i Themelimit është bartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është bartuar në pajtim me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ortakët

Emiljan Leka


Arben Vrushi


Bleri Dervishi


STATUT I SHOQERISE
“NELCO” SH.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 10/10/2023, në Tiranë, personat e mëposhtem:

Z.Arben Vrushi, shtetas shqiptar, lindur më 28.09.1966 në Elbasan, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 034148865, me nr. Personal G60928006U, madhor e me zotesi te plote per te vepruar;

Z. Bleri Dervishi, shtetas shqiptar, lindur me 22.10.1993 ne Korçë, mbajtes I Letërnjoftimit me nr. 035678793, me nr. Personal J31022026C, madhor e me zotesi te plote per te vepruar;

Z. Emiljan Leka, shtetas shqiptar, lindur me 26.02.1990 ne Gruemire, mbajtes I Letërnjoftimit me nr. 0035337758, me nr. Personal J00226142L, madhor e me zotesi te plote per te vepruar.

ne përputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 10/10/2023, themeluesit e mësipërm, vendosëm të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “NELCO” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

- Grumbullimi dhe përpunimi BMA (Bimë medicinale aromatike), mbetjet e Agrikulturës dhe Akuakulturës.
- Prodhimi I ekstrakteve Botanike.
- Prodhimi I substancave të pastra biokimike natyrale me teknologji të gjelbër.

2. Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.

3. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

Neni 4 Selia

4. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Çlirimi, N 16/360, Zona Kadastrale 8522, Elbasan, Shqipëri.

Me vendim te Administratorit, Shoqëria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **ALL 10,000 (dhjetë mije lekë)** dhe zotërohet në masën 50% nga **Arbren Vrushi**, zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **5,000 (pesë mijë lekë)** ,25% nga **Bleri Dervishi** zotërues e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **2500 (dymijë e pesëqind lekë)** dhe 25% nga **Emiljan Leka** zotërues e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **2500 (dymijë e pesëqind lekë)**
- Kontributi i ortakëve është në para.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të behet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Transferimi i kuotave

- a) Kuotat janë lirisht të transmetueshme ndërmjet ortakëve;
- b) Në rast transferimi të çdo lloji forme, si me, ashtu edhe pa shpërblim, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen paraprakisht ortakëve të tjerë;
- c) Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetin, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje;
- ç) Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se ata kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes;
- d) Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes;
- dh) Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- e) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- f) ndryshimet e statutit;
- g) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- i) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtroje kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.

Neni 10

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet etjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 13

Përfshirja nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z.Bleri Dervishi**, shtetas shqiptar, lindur më 22.10.1993 në Korçë, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 035678793, me nr. Personal J31022026C, madhor e me zotesi te plote per te vepruar;

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrine likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

.Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 19
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 20
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NELCO” SH.P.K

Emiljan Leka


Arben Vnashij


B. L. D. L.